



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë nenin 22 paragrafi 1 në lidhje me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/20219) dhe nenin 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancën e 46 të mbajtur me datë 12.02.2021, KSHPK morri

### VENDIM

**Është konstatuar gjendja e konfliktit të interesave, tek personi** ..... - deputet në Kuvendin e RMV, përshkak se pas emërimit në funksionin e përmendur, menaxhimin me shoqërinë aksionare ..... Shkup, ia ka besuar anëtarit të familjes (bashkëshortes), gjë që është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në përputhje me nenin 114 paragrafi 3 në lidhje me nenin 45 paragrafi 1, i dënuar me nenin 105 paragrafi 1 alinea 2 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, ngritet procedurë për barazim me lëshimin e urdhër-pagesës për kundërvajtje kundër personit zyrtar ..... deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### SQARIM

Lënda me numër 09-952/1 me datë 01.03.2021 është formuar me vet iniciativë në bazë të kontrollimit të rregullt në Formularin – Deklaratën për interesa dorëzuar nga ..... – deputet në Kuvendin e RMV, përshkak se pas zgjedhje në funksionin e caktuar, menaxhimin me shoqërinë aksionare ..... Shkup ia ka besuar anëtarit të familjes së vet (bashkëshortes), gjë që është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit.

Në përputhje me nenin e përmendur:

- (1) Personi i cili merr funksion me zgjedhje ose emërim, me përjashtim të personave të cilët marrin funksion i cili nuk ekzekutohet profesionalisht, nëse menaxhon me shoqëri aksionare ose institucion si pronarë, është i obliguar që parase të merr funksionin menaxhimin duhet t'ia beson personi tjetër ose trupi, përveç anëtarëve të familjes së vet, gjatë kohës derisa kryen funksionin, autorizimet publike ose obligimet.*

..... është i zgjedhur si deputet në Kuvendin e RMV me akt numër 08-2358/1 me datë 04.08.2020. pas kontrollimit të rregullt në Sistemin distribues të Regjistrisë qendror të Republikë së Maqedonisë së Veriut me datë 12.02.2021 është vërtetuar se personi i përmendur nëpërmjet parashtruesit ..... ka dorëzuar fletëparaqitje për ndryshime në menaxhimin e shoqërisë aksionare ..... Shkup, me datë 17.08.2020 deri tek Regjistri qendror i RMV, me çka është marrë vendim me datë 24.08.2020 dhe për menaxhues të kësaj shoqërie aksionare është emëruar personi ....., bashkëshorte e personit .....

Në përputhje me nenin 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave ky Vendim dorëzohet deri tek personi zyrtar ..... – deputet në Kuvendin e RMV, me të cilën i rekomandohet për obligueshmërinë që të menjanion gjendjen

e konfliktit të interesave, gjegjësisht menaxhimin me shoqërinë aksionre ..... Shkup, t'ia beson personi tjetër ose trupi, përveç anëtarëve të familjes së vet.

Personi zyrtar ..... – deputet në Kuvendin e RMV, nevojitet që ta informon KSHPK me dorëzimin e dëshmimeve për veprimin në afat prej 15 ditë nga dita e dorëzimit të këtij vendimi.

Në bazë të nenit 114 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK personit të emëruar i shpqipton dhe i dërgon urdhër-pagesë për shkelje të nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dënuar sipas nenin 105 paragrafi 1 aline 2 nga ligji i njëjtë.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të konstatuar, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit në seancën e mbajtur me datë 12.02.2021, ka vendosi sipas dispozitave.

KOMISIONI SHTETËROР ПЁР  
PARANDALIM ТЁ KОРРУПСИОНИТ  
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të KSHPK  
Përpunoi: K. Z., këshilltarë  
Miratoi: G. T., anëtar i KSHPK

